

VJERSHA  
DHE POEMA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

84-1

B67

KIÇO  
BLUSHI


SONTE  
DHE  
NESËR  
NE  
MËNGJES

814-1  
13 67

KIÇO BLUSHI

# SONTE DHE NESËR NË MËNGJES

vjersha dhe poema



11486  
FOZ5X

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SONTE DHE NESËR NË MËNGJES

Sonte, e qeshura jote  
nëpër qiellin e lagjes  
ndahet në qindra copëza-thërrime.  
Nesër në mëngjes, zogjtë,  
para se të marrin fluturimin e largët,  
do të fillojnë të ushqejnë këngën  
me të qeshurin tënd të mbrëmshëm,  
të ngelur e të shpërndarë  
mbi të gjitha çatitë  
e lagjes...

## EKSKAVATORI 4 M<sup>3</sup> DHE POETI

Si mijëra mendime  
bien mijëra pika shiu.  
Ekskavatori, mes baltës,  
kovën e zhyt në tokën e lagur.

Sa mirë do të ishte  
sikur çdo varg,  
para se ta hidhja në shtyp,  
thellë ta zhysja në tokën e dashur  
për të nxjerrë prej andej  
llucën që na ngjitet në çizme e në zemër,  
që na pengon të shkojmë më shpejt te  
e nesërmja,  
që na pengon të shkojmë më shpejt  
te pjesa më e mirë  
e vetes sonë.

## NATËN E MIRË, POLIC!

Kafenetë mbyllen.

Shoferët e fundit të urbanëve  
nisen më këmbë për në shtëpi.

Batanjen e ftohtë të mesnatës shtërngojnë pas  
shpatullave bulevardet.

Natën e mirë, polic!

Njerëzit këthehen në dhomat e ngrohta.

Era e bukës së thekur,  
parfumi i çarçafëve të pastër,  
e puthura e fëmijës në gjumë,  
çelësi i abazhurit që mezi pret të shtypet,  
kockat e lodhura që mezi presin të çlodhen –  
ndihen deri jashtë  
në asfaltin e lagur.  
Natën e mirë, polic!

Jemi t e rrethuar.

Kemi kaq shum e armiq.

Nj   sy duhet mbajtur zgjuar  
q   armiku i klas  s, tin  z,  
t e mos na verboj  .

Nat  n e mir  , polic!

N  n mushaman   t  nde  
nata s  duhet t e sjell     ndrra  
p  r k  revate t e ngroht  ,  
p  r gjum   pa shqet  sim  .  
Nat  n e mir  , polic!

Do t e doja t e t e z  vend  soja sonte,  
t e shkoje sonte edhe ti te gruaja,  
t e shtriheshe sonte edhe ti i shkujdesur  
pran   gruas,  
pran   kalamajve,  
pran   qet  sis  ,  
Nat  n e mir  , polic!

N   koh  ra t e tilla  
u dashk  rka t e mbajm   nj  rin sy hapur.  
Ky sy sonte je ti,  
nes  r jam un  ,  
pasnes  r im bir.  
Nat  n e mir  , polic!

Sonte harron ti  
qetësinë dhe ngrohtësinë e çarçafëve  
që të flejnë njëmijë të tjerë  
krejt të qetë,  
që bllokada, tinëz,  
sytë e lirisë të mos i nxjerrë.  
Natën e mirë, polic!

## ARMIKU I KLASËS

Gishtat mbushur me unaza,  
një palë këpucë të arnuara në sup,  
një thes me plehra nga koh' e Zogut,  
një zë që rrënjët i ka në nostalgjinë për sultani  
Hamitin,  
një sahat që kohën e mat allaturka,  
një palë sy të mefshtë që shohin vetëm prapa,  
një palë duar të vockëla e të bardha që djersën  
e tjetrit lakmojnë —  
me vete solli  
në qytetin e studentëve  
i fundmi i matrapazëve,  
i fundmi i batakçinjve.

Erdhi,  
si igrasia e banjos  
kur çahet tubi i sifonit.

Erdhi  
me shpresa të mëdha  
nga bursa e studentëve  
mos zhvaste diçka . . .

Ish-nëpunës i lartë i Zogut,  
sot i përkultur, dashamirës, ikurak;  
ish- «shtyllë e palujtshme e kombit»,  
sot i pavlerë, qesharak;  
ish-student në Francë a në Austri,  
sot matrapaz profesionist,  
profesionist batakçi.

Të gërmosh pak në sytë e tij  
veç ëndrrës së perënduar të qypave me florinj,  
veç tapive të djegura të tokave,  
veç qejfeve, kabareve, prostitutave  
do të gjesh diku  
të fshehur me kujdes  
diplomën për doktor: exellancë!  
mbiemrin e fikur:

oxhak i lartë,  
familje e lashtë  
dhe fundin e tij e të fisit të tij,  
dhe hirin hakmarrës të kohës,  
që origjinën e tij  
përfundimisht e mbulon.

## **F I E R Z A**

Rrugë drejt maleve,  
male drejt rrugëve.

Fytyra të njohura  
që i kam parë  
në kinokronikat e vjetra tashmë,  
në kantieret që nuk ekzistojnë më.

Sa më shumë plaken dhe thinjen këta njerëz  
aq më të mëdhenj  
e më të fuqishëm  
i bëjnë hidrocentralet.

## URA E PRISHUR NË DHJETOR NGA DRINI

Format e grykës së Drinit  
kanë humbur  
nën mjegullën e shiut.

Rropama e marrosur e ujit  
sjell dele të mbytura,  
pisha e rrënëtë të shkulura,  
gurë që rrezikojnë  
mundin dhe djersën e klasës.

Ura e prishur, e thyer, —  
si një gojë e shqyer  
me një fjalë të pathënë dot në mes.

Rrjedh e buçet e godet pa mëshirë  
marrëzia e ujit.  
Shi.

Drini nxjerr një U—U—U—U—U të gjatë sa një vetëtimë.

Shi.

Punëtorët, me mushama të gjata e të zeza,  
vrapojnë nëpër natë,  
gjoksin t'i venë

uji t që rrjedh e buçet e shkallmon

pamëshirë

mundin e vitit.

Shi.

Drini e theu urën.

I këputi për pak kohë  
marrëdhëniet e përditshme që kishim  
me urbanin, me gjumin, me fëmijët,  
me gratë.

Shi.

I shkreti Drin!

Akoma i beson

marrëzisë së tij,

akoma s'e ka kuptuar

## që punëtorët

do t'ia shtrëngojnë fytin ag fort

sa sytë t'i lëshoínë.

natë e ditë

xixa frike

që do të maten me miliona ku

#### **energii elektriike**

Dhe urat  
s'do t'i thyejë dot më,  
dhe arat  
s'do t'i përmbytë dot më.

## PEISAZH NGA DRINI I QETUAR PAS NATËS SË DEVIJIMIT

Tani minatorët dhe sondistët  
hedhin grepat mbi kurrizin e zbutur të Drinit  
për të kapur jo peshk  
po nënshtrimin e tij.

Buldozierët kanë shkuar në oficinë  
të venë ndonjë dhëmb të rënë,  
të mjekojnë ndonjë shpatull të plagosur  
në luftë.

Eshtë apo s'është ky Drini i mbrëmshëm  
që lëpihet tani në këmbët tonë si një mace  
e butë,  
që duket sikur mund të kapet  
edhe me një grep të vogël peshku?!

## GRUPI I PLASJES SË MINAVE

Dhjetëra ton dinamit  
i futëm malit në gojë.  
Rezistencën e telave,  
rezistencën e nervave të tokës,  
rezistencën e zemrës sate  
dhe zemrës sime,  
masim me ohmetër.

Megjithëse je veshur me pelice,  
dëbora  
të ka nisur nuse.  
Nga qelli vijnë mijëra telegramë:  
«Qofshi të lumtur!»


Mua, si zakonisht, më është skuqur hunda.  
Ne shihemi mes flokëve të dëborës,  
ne shihemi mes rezistencës së tokës,  
ne ecim mbi dhjetëra ton dinamit.

Dhe e dijmë  
se lumturia jonë  
shpërthime masive bën  
mbi tokë.

## PELIÇJA IME NË VA TË DEJËS

Ti rri varur në gozhdë  
pas derës së barakës, në kantier,  
e trishtuar, e rrudhur, akoma e lagur.  
Si një mik i mirë më sheh dhe hesht,  
kurse unë s'e kam të vështirë  
pyetjen tënde të dhimbshme të kuptoj:  
«Do të ikësh përgjithmonë?»

Dhe mblidhesh shuk,  
aty, pas derës së barakës,  
si një grua e duruar që e përjeton ditëndarjen  
krenarisht,  
si një nënë e dhemshur në ditën kur do t'i ikë  
i biri,  
si nënët e mira që baltën, shiun, mundimet,  
hallet, të ftohit  
duan t'i ruajnë për vete  
pa u ankuar kurrë —  
vetëm që djemptë të jenë.



## «Vërtet do t  ik sh?»

Ti je si nënët.

që dashurinë s'e kanë kurrë për sytë e të tjerëve  
ashtu si dhembjen  
s'e kanë kurrë për t'u dukur.

## NË NJË XHIRIM TË DËSHTUAR FILMI

Ishte hera e parë  
që shkoja në xhirim.  
Ishte hera e parë  
që më vinte turp  
nga arti.

Gati blici!  
Dhe me një shishe uji  
regjisori lag  
fytyrën e buldozeristit,  
gjoja se ky  
na qenka djersitur.

Dhe operatori, fap,  
shkel sustën e aparatit.  
Syri i objektivit  
filloi të gëlltisë  
fytyrën e habitur  
të buldozeristit Selim.

Lëvizte i shkreti  
brenda peliqes  
si brenda morsës:  
duhej të imiton te vetveten  
(një vete që nuk e njihte),  
duhej të shtrëngonte nofullat  
pa asnë arsy,   
kot së koti.

Stop! — thirri papritur,  
regjisori Kasëm.  
Syri i objektivit  
u shua  
si një shkrepse.

— Duhet të rruhesh! —  
tha regjisori, i nxehur.  
— Shko në barakë  
dhe vish  
një tjetër këmishë.  
Edhe peliqen  
që e ke me vajra,  
pisë,  
hiqe!  
Edhe fytyrën,  
më ekspressive!  
S'ka gjë se devijimi  
u bë  
gjashtë muaj më parë.

S'ka gjë se tani,  
nuk ka më masive  
shkëmbinjsh.  
Ti përfytyro  
sikur mbi dallgë hidhesh,  
sikur shkëmbinjtë do të hash  
me dhëmbë,  
sikur mbi ty  
gurët bien me rropamë  
nëpër natë.  
Përfytyro se je baba  
dhe në darkë të presin kalamajtë...  
Ti, me një fjalë,  
nuk pyet...

Për të mos na fyter,  
buldozeristi Selim  
papritur qeshi.  
— Unë, vërtet, nga diskutimet tuaja  
s'marr erë,  
por, ama,  
kurrë nuk e ha  
ujin për djersë,  
bojën e kuqe për gjak,  
blicin për diell...  
Të kishit ardhur, vëlla,  
kur devijimi ishte devijim,  
kur djersa ishte djersë,

kur gjaku ishte gjak,  
kur Selimi ishte Selim . . .

Kjo ishte  
hera e parë  
që më vinte turp  
nga arti.

— Dëgjo këtu, Selim!  
Ne jemi artistë  
dhe s'bëjmë një të thjeshtë  
fotografim.  
Ne duam të të ngremë lart,  
në art,  
se, për ne,  
e zakonshmjë, ordinerja,  
s'ka vlerë . . .

— Më ler, vëlla,  
të jem i zakonshëm  
pavarësisht  
nga dëshira tuaj.  
Se ndryshe,  
në atë filmin tënd  
s'do të më njojin  
as gruaja, as fëmijët,  
as shokët . . .  
Më ler,

kështu, si jam.

Nuk më pëlqen që ti  
të më ngresh më lart  
se ç'më kanë ngritur  
Partia ime,  
krahët e mi.

Kjo ishte  
kënaqësia më e madhe  
që më ka dhënë ndonjëherë  
arti ...

Qendrë përgjegjë se kështetjet e kështu  
vullxhija e njësi shtetërore, që i cili është

## KUJTIM PËR RRUGËN «KOÇO ÇAMÇE»

Më zuri malli  
për një grusht dëborë,  
për rrugën që mban emrin e dëshmorit  
Koço Çamçe  
të vrarë në rrugën e fëmijnisë sime,  
në rrugën me kalldrëm  
pranë çezmës ku mbushnim ujë të gjithë,  
pranë shtëpisë sonë,  
kur nëna ime  
akoma ishte nuse.

Nëpër muret e bardha,  
që gratë e lagjes i lyejnë çdo vit me gërqele,  
(kur shkrin dëbora)  
ka mbetur diku  
fëmijnia ime e bardhë...

Kur çamaroköt e vegjél  
ckérmitin muret.

gjejnë akoma vizatimet tona me qymyr:  
një pushkë, një yll, një top prej lecke...  
Gjejnë akoma gërmat tona:

(Shkruanim më shumë në mure se në fletore)  
«Rroftë Komandanti!»  
«Rroftë Pushteti Popullor!»

Më zuri malli  
për një kokërr dardhë,  
për një dardhë që pikon me bujë  
nëpër ullukët e teto Ulisë...  
Ç'pikonin çative  
të pjekurat dardha  
që aq shumë gëzim  
u sillnin fëmijëve!

Më zuri malli  
për një shaka në familje.  
Rrotull sofrës  
të mbledhur të gjithë,  
«një kope me fëmijë»,  
hanim memeliqe,  
hanim trahana  
e pastaj këndonim:  
«O Çurçill, o kokë ka!»...

Qeshte gjyshja me dhëmbët e rënë,  
vëllai i vogël hundët fshinte,

nëna bëhej gati radhë për bukë të zinte,  
ndërsa macja e plakur, e zezë,  
një kockë lëpinte...

Kurse ne rriteshim, rriteshim shpejt,  
pa duruar vitet të vinin,  
pa pritur qimet  
poshtë mjekrës të na mbinin.

C'më zuri malli  
për gratë e gjëzuarat të lagjes,  
që burrat prisnin pragjeve...  
Netët me hënë vinin e iknin  
ndërsa nënët prisnin e prisnin  
të ktheheshin burrat  
nga rrugët e largëta,  
nga hallet e atdheut.

Po ja, u rritëm ne  
dhe larg shkuam të gjithë.  
Nënët mblodhën lotët në shami,  
shamitë i fshehën nëpër xhepat e mësallave,  
mësallat i kishin akoma me miell të bardhë  
nga kulaçët e byrekët që na kishin bërë gjatë  
natës  
për të na uruar rrugë të mbarë  
në mbarësinë  
e ditëve që na prisnin.

Ç'më zuri malli,  
për një grusht dëborë  
dhe për një fjalë  
prej nëne.

## A T E N T A T O R I

Emrin e tij  
rrugët e Tiranës  
e njohin vetëm si krismë.

Por kur nëna iu lut t'i therrte një pulë  
ai tha:  
«S'e bëj dot,  
më dridhet dora  
dhe sytë  
mjegull më shohin . . . »

## KËNGË DJEPI E KËNDUAR NË DY KOHË TË NDRYSHME

### I.

I dëgjon, o bir,  
nënët dhe nuset si qajnë?  
Lëndink' e lotëve është  
shtrati im i nusërisë,  
lëndink' e lotëve është  
zemra ime, biro.

I dëgjon nënët dhe nuset si qajnë?  
«Mu në breg të detit  
vaporë ka dalë...  
Ku vete, mos vafsh i gjallë?»

Mos m'u rrit shpejt, biro,  
që koha të zgjatet më shumë,  
nga zemra e nënës mos ikësh  
si ikën nga mali një lumë.

## II.

Fli, o bir, fli  
të rritesht shpejt  
të bëhesh burrë,  
nga duart e nënës të ikësh  
si ikën nga mali një lumë.

I dëgjon partizanët në oborr?  
Në shi  
për diellin këndoijnë,  
në shi  
për beharin këndoijnë,  
në grykë të ujkut  
për ty, që të rritesht, këndoijnë.  
Unë po hesht, biro,  
që këngën e tyre  
ta dëgjosh më mirë.

## PËR NËNAT

Përse nënata tonë  
në të zeza visheshin,  
sytë i kishin të mbytur në zi  
që në moshën  
tridhjetë e pesë vjeç?

Se në këtë kohë  
ne ishim bërë burra  
dhe atyre u vinte turp  
nga botëzeza  
dhe nga ne . . .

Se në këtë kohë  
ato do të kishin patjetër të vrarë  
o djalin,  
o burrin,  
o vëllanë.

Ndoshta kjo është arsyjeja  
që edhe në dasmat tona  
nënënat tona qajnë.

## RRËFIM SEKRET I GJYSHES NUSES SIME

Na mbyllën të dy në një dhomë.  
Mua zemra më rrihte, më rrihte  
si dridhet një zog  
i mbetur në shi.

Burri u ul mbi krevat,  
mbi mëndafshin e kuq të jorganit,  
të jorganit që e kisha sjellë në pajë,  
në pajë-zezën që kisha sjellë në sepete, —  
në sepete kisha futur zemrën time të vogël  
që dridhej si një zog  
i mbetur në shi.

Mëndafshi i kuq i jorganit u rrudh,  
mua më pikoi në zemër.  
Jastëku i qëndisur nga unë  
aq net e aq ditë  
si dëborë, si akull m'u duk.

Qëndroja mes dhomës e ngrirë  
gati të plasesha në dysheme.

— Ngrije pak tylin, moj nuse!

Dysh apo as më je? —

Unë isha duke rënë

mbi dysheme,

kur dora e tij

tylin

nga sytë

po më hijte . . .

. . . Të nesërmen në mëngjes u zgjova e para  
e trembur:

Të çohesha apo të bëja sikur flija?

Nuk i dija huqet e shtëpisë

ashtu si nuk i njihja

fytyrën dhe duart e tij.

Palëvizur qëndroja nën jorgan

se nuk doja që ai të zgjohej,

se nuk doja që ai të shihte

brenda syve të mi

të mbushur me lotë.

Por ai më ndjeu pas pak

e me zë të ngjirur

nga rakia e nga këngët

më tha me inat:

— Akoma s'qenke çuar

Kaq vonë zgjoheshe te jot ëmë?  
Kush do t'i lajë enët e dasmës, aneja?

Erdhën të më shohin të hënën pasdite  
me pasta, me torta e bakllava  
të gjitha gratë e fisit tim.  
Më hoqën mënjanë e më pyetën  
si pyeten nuset,  
si ngacmohen nuset.  
Vetë pyesnin,  
vetë përgjigjeshin.  
Unë heshtja.  
Ç'të thosha?  
Ç'të tregoja?  
Më kishte mbytur turpi.

Përse ka lindur vallë ky zakon  
që të hënave pasdite  
nënët, e gratë, e motrat  
nuseve u shkojnë  
me torta?  
Që, të paktën, me sherbet  
nusja zëmrën ta ëmbëlsojë.

Pastaj,  
linda  
fëmijën e parë.  
Gjithë dashurinë për jetën

e derdha te fëmijët  
që më lindën njëri pas tjetrit.

E kam dashur burrin?  
Nuk them dot jo.  
M'u thaftë goja!  
Ai është baba  
i fëmijëve të mi . . .

## B A R D H È S I

Përse stërgjyshërit  
shtëpitë i bënин me frëngji?  
Që të mos u futej nata në sy.

Përse e kemi kostumin kombëtar të bardhë?  
Përse kemi mbajtur qeleshe të bardha?  
Që shqiptarishqiptarin  
të mos e vriste në terr.

Përse lahuta nxjerr tinguj të bardhë?  
Që nata  
të mos na i hante köngët.

## FJALËT E FUNDIT TË GJERGJ KASTRIOTIT

Te bregu i detit,  
buzë Shqipërisë,  
ka një qipariz —  
atje lidhni  
kalin tim.

Përmbi kalë,  
mbi dori,  
hapeni flamurin tim —  
atje vini  
shpatën time.

Era kur të fryjë,  
deti kur të nxihet  
kali do vrapojë —  
nëpër Shqipëri  
shtëpi më shtëpi.

Qielli kur të çahet,  
shihni ju flamurin  
përmbi kalin tim —  
që vrapon, vrapon  
burrat burrëron.

Në mes të flamurit  
flakëron liria,  
vdekja fle te shpata ime —  
turk, o turp i zi  
turp, o turk i zi.

## MOTIV NGA VITI 1920

«Gabriele d'Anuncio dërgoi në Shqipëri dy motoskafë me 30 milion fishekë. Oficerët, të cilët shpunë këto në Shqipëri, janë të ngarkuar të jepin urimet më të mira të poetit për çështjen shqiptare».

10 shtator, 1920.

(Nga shtypi)

Ulëri sa të duash, Gabriele d'Anuncio,  
çirre gjoksin tënd me artikuj e protesta —  
të vrarët tuaj të Vlorës,  
legjionarët e tu romakë,  
nuk u ngritën dot më këmbë  
të dëgjonin urimet e tua emfatike;  
nuk i morën dot 30 milion fishekët e tu.  
Nuk i mbushin dot pushkët  
30 milion vargjet e tu politikë  
për të vrarë  
një milion shqiptarë.

Me 30 milion fishekët e tu  
ti nuk doje të vrisje vetëm shqiptarët;  
ti vrate dhe vret vazhdimisht  
të gjithë ata italianë  
që mbushin pushkët dhe sytë  
me plumbat  
dhe vargjet e tu.

## MARIA STJUART

Gjakderdhja  
është syri i mbretërve.

Ti s'mund ta shihje botën me tjetër sy,  
ti s'mund ta ngrije fronin mbi tjetër mbështetje  
veç mbif rrënjët e gjakut.  
Ti s'mund të kiske tjetër gjuhë  
veç gjuhës së gjakut.

Më kot i ke futur historianët në telashe  
gjatë këtyre pesëqind vjetëve,  
më kot ngrihen pyetjet absurde  
rrotull emrit tënd të përgjakur:  
Ç'është Maria Stjuart?

Vrasëse  
apo shenjtore?

Bibliotekat e botës  
më kot i stivosin këto pyetje.

Deri sot nuk është gjetur një mbret  
që të mos ketë hyrë në histori si një Makbeth,  
që të mos ketë dalë nga historia si një Zogoll, —  
ndryshe, mbreti s'quhet mbret,  
mbretëresha s'quhet mbretëreshë.

Më kot artistët, lakenj të oborreve,  
në kokë  
të venë kurorën e pasionit pa cak,  
më kot shkencëtarët deshifrojnë sonetat e tua  
dashurore.

Ti mbetesh një përmendore gjaku  
e zbukuruar nga tantellat e mëndafshta  
të sonetave të tua;  
ti je fytyra e zbuluar e të gjithë mbretërve  
prandaj dhe kolegët të vranë.  
Nuk të vranë pér vrasjet, jo,  
se ndryshe të gjithë duhej më parë  
të ekzekutonin veten,  
por se nuk dite të tregoheshe e pafajshme,  
shenjtore,  
perëndeshë e drejtësisë tokësore.

Ky ishte faji më i pafalshëm  
i kurorës mbretërore.

Gjakderdhja  
është syri i mbretërve.

Eshtë gënjeshtër e shpikur nga mbretërit  
të thuash  
se pasioni i dashurisë të çmendi  
të vrasësh burrin.  
Jo!

Gjaku mbretëror  
nuk mund të ketë të tjera rrënje  
veç gjakun,  
kurora mbretërore  
nuk mund të ketë të tjera gjethë  
veç kufoma.

## RAPSODI E RE PËR QIELLIN

Në këtë shekull të njëzetë,  
në këtë shekull që disa e quajnë me mburrje  
shekull elektronik,  
superfuqitë grinden e zihen e theren  
për të vendosur mbi qiejt e popujve  
kufij ushtarakë.

Kufij mbi sytë e popujve.  
Mbi kokën e çdo qytetari  
një aeroplan ushtarak  
hije lufte lëshon.  
Mbi kryet e çdo populli të vogël  
jo më pak se një satelit spiun  
gjumin e fëmijëve e të porsamartuarve,  
grevat, protestën, të gjitha lëvizjet  
e proletariatit  
ruan nga lart.

Më shumë se kurrë,  
si një monedhë e vjetër  
me të cilën s'blen dot asgjë,  
fjala liri,

e përdorur aq shumë nga renegatët  
dhe presidentët  
në mikrofonët e tyre,  
ka humbur çdo kuptim  
duke përjashtuar, sigurisht,  
lirinë e aeroplanëve ushtarakë për të hedhur  
bomba,  
lirinë e satelitëve spiunë për të përgjuar,  
lirinë e superfuqive  
për të bërë grushte shteti  
mbi kokat e popujve.

Në këtë shekull të njëzetë,  
fatkeqësisht,  
ka dhjetëra shtete  
dhe mijëra miopë  
që satelitët spiunë  
i quajnë yje,  
që aeroplanët ushtarakë  
i quajnë shpëtimtarë  
të qiejve të tyre.

Ne, për vete,  
s'kemi për të lejuar kurrë  
që aeroplanët e huaj  
të na e katandisin qiellin  
të vockël, të vockël, të vockël  
sa syri i një aparati televiziv.

Mbi këtë tokë s'do të ndodhë kurrë  
që një sy i panjohur  
të na fotografojë, fshehur nga lart,  
fluturimin e zogjve,  
sepse edhe në krahët e tyre ne shohim  
një pjesë të lirisë  
dhe të pavarësisë.  
Askush s'do të mund të na fotografojë nga lart  
as kumbullat kur na çelin.

Sepse e dimë,  
që atë vit,  
ndoshta, përgjithmonë,  
lulet e kumbullave do të na digjen  
dhe raki  
për dasma e inagurime  
s'do të kemi më.  
Dhe grurë, sigurisht,  
s'do të kemi më.

Në negative mikrofilmash  
vizonet e kokave të qethura të kalamajve,  
që luajnë në oborret e shkollave, buzë lumenjve,  
s'do të na i mbledhë kurkush.

Sepse e dimë  
që nga ajo ditë  
fëmijët do të na ngelen –  
shkurtabiqë.  
Dhe, me siguri,  
që nga ajo natë

s'kanë pér tē na lindur mē —  
gratë.

Sepse pushtimi i qiejve do tē thotë  
pushtim i mushkërive tē çdo njeriu,  
pushtim i mundësisë pér tē pasur gjelbërim.  
Pushtim i qiejve do tē thotë  
pushtim i horizontit tē syve,  
pushtim i pavarësisë së motit,  
pushtim i tē drejtës pér tē pasur  
ciklin e zakonshëm tē shirave, tē dëborës, tē erës,  
ciklin e natyrshëm pér tē qenë fëmijë,  
adoleshent, burrë, plak.

Pushtim i qiejve, në fund tē fundit, do tē thotë  
heqje e tē drejtës  
pér tē mbajtur kokën lart.

Kur qiellin e shpon tejpërtej  
kamera e një aeroplani spiun  
nga tē gjithë fjalorët duhet fshirë menjëherë  
fjala më e qartë, më e pavarur, më e pastër-qiell,  
fjala më e preferuar e tē gjithë poetëve dhe tē  
dashuruarve — qiell,

fjala më e lirë, më krenare-qiell...

Kur kam qenë më i ri  
kam pas bërë këtë vjershë:  
Këpusni një copëz qiell  
nga qielli i lirë i Shqipërisë  
vendoseni atë midis mijëra copa qiejsh të tjerë-  
qiellin e vendit tim kam për ta njojur menjëherë  
për të vetmen arsyé  
sepse në të  
yjet  
janë yje.

## 1 M A J I

Ka një ditë viti  
kur qielli merr ngjyrën e gjakut,  
kur ora e kuqe e diellit  
thërret e buçet:  
Hapat e mi  
të çojnë në komunizëm! —

Kjo ditë është  
1 Maji.

Ka një ditë viti  
kur renegatët dhe revisionistët  
veshin këmisha të kuqe,  
mbajnë fjalime, bëjnë deklarata  
për pajtim vëllazëror  
të klasave armike...  
Dhe rrugët e paqes i kthejnë në autostrada,  
në parqe verore ku fjalët e bukura bëjnë piknike,

në lëndina me luleshqerra, ku çdo luleshqerrë është  
një reformë...

Por kjo ditë s'është, jo,  
1 Maji!

Ka një ditë viti  
kur era zë e fryn më fort  
dhe dafinat prej cellofani të renegatëve,  
luleshqerrat, pikniket, fjalët-trëndafila,  
para se të vijë vjeshta  
fshesaxhinxjtë i hedhin në koshat e plehrave  
së bashku me reklamat e fjalimet e përbetimet,  
së bashku me flamurët e ngjyrosur me bojë të kuqe  
(kujtimi i Çikagos!) —  
të gjitha të parafabrikuara një natë më parë  
në zyrat e bankave  
apo të ministrive të brendshme  
(në kujtim të Çikagos!)  
Kurse era fryn fort...  
Hyn në mikrofonat dhe në kamerat televizive,  
hyn në fjalime, në buzëqeshjet e revisionistëve,  
në citatet e marra nga Lenini,  
në flamurët që skuqin  
(në kujtim të Çikagos! — thotë oratori vetulltrashë).  
Dhe era fryn më fort,  
dhe era thotë:  
Flamurët janë të kuq

sepse janë lagur në sheshet e Pragës me gjak,  
sepse janë ngjer në tokën e Polonisë me gjakun  
punëtor..

Në tribunën qëndrore  
era fyrn akoma më fort,  
këmishën e kuqe të oratorit vetullzi e shpalos  
për t'u dukur nën të  
smokingu i aristokracisë,  
këmisha e zezë fashiste —

ky është  
1 MAJI!

## T A D I S H

Një njeri që s'dashuron dot kurrë  
gruan, tokën, shokët, qiellin e atdheut, prindërit,  
një njeri që nuk urren dot tërësisht  
armikun, meskinin, mikronjeriu, burokratin,  
dhe më në fund, edhe ai që pajtohet e bën sikur nuk  
i sheh

të gjithë këta mikronjerëz —  
është si një armë e thyer,  
është si një armë e hedhur në fushën e betejës  
dhe ngelet aty  
që ta marrë errësira, mosgjëja.

Dhe në qoftë se kjo armë  
nuk do të vrasë dot dashurinë dhe urrejtjen tënde,  
ta dish, —  
ajo patjetër nesër do të vrasë  
dashurinë dhe urrejtjen  
e shokut tënd.  
apo të birit tënd.

## M A R R E D H E N I E

Pérse qan qielli, babi?

Nuk e di.

Pérse u zemërua lumi, babi?

Më ler rehat.

Po lulet, vdesin?

Ik, se më vdiqe.

Ti mos vdis, babi, ti mos vdis!

Zhduku, të them!

Po bombë atomike ke në xhep ti, babi?

Thyej qafën, dreq!

Si thua, ba, ia hedhim vdekjes, që ty don të të  
marrë?

Kush tha që don të më marrë?

Ti, ba, ti the...

Mos qaj, shejtan, se do të të rrah....

Ç'do tē bënim ne  
tē rriturit, tē pjekurit, tē moshuarit,  
sikur njerëzit që duam  
tē na silleshin kështu?  
Kurse fëmijët,  
megjithatë,  
na puthin...

## FAMILJARE

Kur vonohet gruaja,  
akrepat e orës  
të mbijnë në sy.  
Të duket sikur  
më shumë qan djali  
dhe soba  
më tepër nxjerr tym.

Kur ora shkon dhjetë, njëmbëdhjetë  
të ngjan sikur  
korbi i Edgar Poes  
vërtet troket në xham.

Dhe kur gruaja  
shkallët e apartamentit  
më në fund i ngjit,  
bën sikur fle, po nuk fle,  
qindra pyetje të cimbisin nervat,

pyetje t  kota, si korba t  zinj,  
q  hyjn  n p r qielin e syve  
si n  sht pin  e tyre. . .

Grindesh. Zihesh. B rtet.  
Gruaja t  sheh me qet si,  
ndoshta dhe buz qesh  
me thumb e ironi,  
sepse vet m ajo  
ka fatin e keq e t  zi  
t  shoh  se si  
brenda qielit t  vock l t  syve t  burrit  
mund t  fluturojn   
qindra korba t  zinj. . .

## KAM TAKUAR NJËHERË NJË NJERI...

Kam takuar njëherë një njeri  
që tërë jetën  
s'kishte pasur asnjë hall,  
që kurrë me askënd nuk dinte të zihej,  
jë shefit kurrë nuk i kundërshtonte,  
që i pëlqente të mos binte në sy nëpër mbledhje,  
që kurrë nuk kishte thënë plot gojën: «po» ose «jo»,  
që kishte mbledhur para në arkën e kursimit,  
që për çdo sezon kishte kostum përkatës  
(për të mos rënë në sy vishtë vetëm një),  
që televizorin e frigoriferin s'e kishte problem,  
që shokun e ri e mbante  
sa q'mban njeriu  
biletën e urbanit.

Kush e njihte nga larg  
me të drejtë mund të thosh:  
ai është më i lumturi i të lumturve,

më i qeti i të qetëve...  
Lum kush do ta marrë për burrë,  
lum ajo zyrë  
që e mban në punë...

Po pas një viti  
gruaja e la  
dhe asnjë shok apo mik nuk u gjend  
të ulej me të në tavolinë,  
t'i thoshte me zemër një fjalë të mirë,  
t'ia pinte kafenë e hidhërimit e t'i jepte të drejtë,  
të hidhte poshtë fjalët e gruas  
të thëna pas gjyqit:  
«Shpëtova nga një gjysmënjeri  
me zemër allcie...»

## NË ORGANIZATË

E turpëruar,  
ajo ul kokën.  
Nga fundi i sallës  
dikush ngre dorën:  
— Si është e mundur  
që dashurinë  
(gjë kaq delikate!)  
ta bëjmë çështje  
organizate?  
Ç'na duhet ne  
të varim në rend të ditës  
zemrën e shoqes sonë,  
Afërditës?  
Ç'na duhet ne:  
e la  
apo s'e la? —

Në sallë  
qetësi e rëndë  
ra.

C'mendonte, vallë,  
shoqja jonë,  
Afërdita?

A mund të hynim dot  
në zemrën e saj  
sic hyn në dhomë  
drita?

Apo kështu  
ia vrismi sytë,  
ia shkelnim zemrën  
«gjë kaq delikate?»

Po sekretari  
nga presidumi u ngrit  
dhe tha:  
— Ti, o Mete,  
sytë i paske  
vetëm për vete.  
Vetëm mishi  
i zemrës sate të dhemb.  
Shkurt,  
ti na qenke  
indiferent.

Ndaj, pa vonuar,  
në mbledhjen tjetër  
indiferentizmi yt  
duhet diskutuar...

Ajo e turpëruar;  
me sytë e mbushur,  
me drojtje, turp e lotë  
nuk di  
q'të thotë...  
Kur salla është  
e mbushur plot  
me shumë të mirë  
shokë.

Para syve të saj  
organizata po ndan  
hidhërimin dhe gjëzimin  
në dhjetëra copë.

## MOMENT LIRIK NË MAJ

Ti mbaje në dorë  
një pankartë të kuqe,  
unë një flamur të vogël  
dhe një tufë me lule  
nga lulet e vazove të nënës.

Me fustan të bardhë  
nën shiun e ngrohtë  
ti ecje e lumtur,  
e lirë të dashurosh,  
të urresh,  
të brohorasësh,  
të mbash lule,  
të duash të nesërmen,  
të ecësh në tokën tënde.

Me flokë të lagur  
nga shiu i Majit

Dhe kushedi përse  
ti ndjeve nevojë të dilje përsëri jashtë,  
të më kërkoje mua,  
të ecje pranë meje,  
të më thoshe fjalë të lira,  
fjalë pa pranga,  
fjalë pa drogë,  
fjalë që s'treten në qiell  
po mbijnë në tokë  
bashkë me grurin,

me shinat,  
me rrugët,  
me barin.

e ditës së parë  
të Majit të Kuq.

S' është zot i këtij vjet  
që nuk ka qetësi  
s' është zot i këtij vjet

s' është zot i këtij vjet  
që nuk ka qetësi

## BUZË SHKUMBINIT, NË ELBASANIN E HEKURT

Pa këngë dhe pa valle në sy,  
pa kostum kombëtar në shpirt,  
pa bukë, pa abetare, pa hekur,  
pa një klasë punëtore të vetëdijshme për rolin e  
vet,  
pa njerëz që nuk kanë frikë të ta thonë të vërtetën  
në sy

edhe kur je ministër,  
liria e çdo populli, shumë shpejt,  
si një hurmë e pjekur  
do të bjerë vetë  
në ujërat e verdha  
të bankave të huaja.

Mjerë kush trupin e ka rastësisht në këtë kohë  
po shpirti i pikon, si një hurmë,  
mbrëmjeve të vagëlluara

**mbi ujërat e verdha  
të shekujve  
gjysmë të vdekur.**

**Jam midis njerëzve  
që eshtrat e Shqipërisë  
do t'i bëjnë  
çelik.**

## PUSHTIMI I ÇEKOSLLOVAKISË

Atë mëngjes  
mbi Evropë  
ra shumë shi  
e tepër mjegull.

Ne rrinim në oborr të parkut automobilistik  
larg, në Va të Dejës,  
me gazetën e lagur në duar.  
Lexonim lajmin e zi  
dhe flisnim për ty,  
Çekoslovakia.

Atë mëngjes  
s'di se kush nga ne  
e gjeti një hartë.  
Gishtat tanë të vajosur, të trashë,  
trupin tënd kërkuan mbi Evropë  
si një plagë.

Ne shihnim  
si futej dora e huaj  
në gjoksin tënd, Çeki.  
Të kujt do të ishin vallë  
fëmijët e tu të nesërm?

Nuk ishte e vështirë të kuptohej  
se ç'do të thotë  
në një mëngjes me shi  
(për dhjetë aspra  
apo për dhjetë korona?)  
ta kesh të shitur Partinë.  
(Kush, pra,  
me shitblerjen e partive u marrka?)  
Dhe komunistët, të përgjumur t'i kesh,  
dhe anëtarët e byrosë politike  
kuklla gome a plumbi t'i kesh,  
dhe vetë të zgjohesh e të shohësh  
po atë mëngjes me shi  
se gjatë natës  
nën vete ke pasur  
një tank,  
se në vend të gjumit  
në sy ke pasur  
gjak,  
se në vend të bukës  
në darkë do të hash  
tradhti,

se në vend të muzikës  
në radion zyrtare  
përgjumësh do të dëgjosh  
demagogji:  
Sovranitet i kufizuar.

Cili, pra, qenka  
kuptimi i lirisë?

Që nga kjo ditë  
në shtypin revizionist  
kur thuhet liri  
me mend duhet shtuar:  
e kufizuar;

kur thuhet  
u bë kjo marrëveshje  
duhet pyetur vetja:  
Cila parti u shit?  
Veç naftës, fuqisë punëtore, grurit e makinave  
sa përqind e lirisë së njeriut  
do të jetë e kufizuar?

Larg, në Va të Dejës  
frym shumë erë,  
bije shumë shi.

\*  
\*\*

E kush ia mohon buzëqeshjet shiut?

Nuk kini parë shi të gëzuar,  
pika të vogla, si mijëra buzëqeshje të tokës,  
pika që luajnë valle nëpër brazda e nëpër fletë misri  
duke hapur fustanet e kaltëra  
si në festën kombëtare të ditës së verës?

Shi i gëzuar, i mbarë, i urtë, i mënçur, bujar —  
lage deri në palcë trupin tim,  
futu thellë në tokën time pjellore  
që nesër të kemi drithë më shumë,  
që nesër të kemi bukë më shumë,  
që nesër të kemi gjelbërim më shumë,  
që nesër të kemi shëndet më shumë.

## B A B A I

Mbrëmjeve, te dera e shtëpisë,  
në qafë i varen  
gjashtë fëmijë.

Vjen në shtëpi  
një herë i lodhur,  
ulet në sofër  
gjashtë herë i çlodhur.

Gjashtë buzëqeshje,  
si gjashtë pëllumbatë bardhë,  
futen çdo mbrëmje në jetën e tij  
gjashtë herë të gjatë.

## PËRSE NUK U INÇIZUA ESTRADA E NJË FSHATI NË DEVOLL

Përgjegjësi i vatrës së kulturës,  
shoku Fejzi,  
përdori të gjitha mënyrat  
të dëbonte bilbilat  
nga korija pranë vatrës së tij.  
Po bilbilat ëknin nga një degë jeshile  
dhe në një tjetër uleshin  
si për inat, si për çudi  
të përgjegjësit të kulturës,  
shokut Fejzi.

Se ishte pranverë  
dhe ata dreq zogj me pendë të arta,  
me atë zë aspak «aktual»  
se nga e kishin marrë vesh  
që në kooperativë kishte ardhur  
Radio Tirana.

Se ishte pranverë  
dhe lopa e Muços  
atë ditë të zezë  
si për inat, si për çudi,  
qiellin e shpoi  
me zë dhe me bri.

Se ishte pranverë  
dhe macet e fshatit  
mbi çatinë e vatrës  
të shokut Fejzi  
guxonin të bënин  
dashuri.

Gjithë ditën ngelëm pa incizuar  
se zogjtë nga dritarja nuk iknin,  
se lopa e Muços çdo minutë pëlliste,  
se macet ishin indiferente për incizimin,  
se gjeli i nënë Lulushes ish çmendur,  
se dega e kumbullës së celur,  
pa mëshirë trokiste në xham.

Se në pranverë  
çdo gjë është krijuar për t'u hedhur  
në shiritin manjetik të trupit tënd,  
të syrit tënd,  
të veshit tënd,  
të zërit tënd.

## P A S   S H I U T

Toka mori atë që i duhej  
për të pjellë  
miliarda jetë.

Edhe ne  
pas çdo kritike,  
si pas çdo shiu,  
në kokë na lindin mendime të reja,  
ashtu si lind bari i ri  
në tokat djerrë.

## BALADA E TRENIT

Të ka në krahë.  
Ti ec me këmbët e tij,  
mbi shinat e tij.  
Të ka futur të gjithën në gjoks,  
kalon mbi ura e në tunele  
që ty të të çojë më shpejt  
aty ku të presin.

Për herë të parë i vjen keq  
që nuk ka gjuhë,  
prandaj vërvshellen i shqetësuar,  
prandaj gulçon si bishë.

Po të çon me krahët e tij  
në stacionin e ndarjes.  
S'ka kohë të trishtohet.  
E presin të tjera stacione,  
të tjerë njerëz,  
të tjera kantiere.

Jeta e tij qenka  
të udhëtojë vazhdimisht  
e vazhdimisht  
njerëzve t'u shërbejë.

## PRANË MINATORËVE

Njerëzit mezi duken  
kur i sheh nga larg.

Po kur futesh brenda në tunelin e plasjes,  
disa metro thellë nën tokë,  
me bark në ujë e mal mbi shpinë,  
mes pluhurit të dinamitit që s'pyet për dhembje koke;  
kur fut kapsollat dhe ndez fitilin,  
kur ngjit me vrap monopatin për të mos u hedhur në  
erë  
kur ndez një cigare në tymin e ankthit: Akoma?  
kur pranë vetes sheh fytyrat e minatorëve të lodhura  
nga vrapi  
njjerëzit të duken male  
kurse vetja  
e vogël. . .

Pranë sakrificës së tyre  
më shumë e do jetën,  
bëhesh më i gjerë, më i ndershëm, më i drejtë –  
ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj botës.

## NËNA E KANTIERIT

Kur në barakat tona futesh ti  
me çarçafë të bardhë dhe ndërresa të pastra në  
duar,  
na duket sikur sjell me vete,  
në atë kantier të largët verior,  
zemrën e nënës të secilit prej nesh.

Në zemrën tënde të madhe  
mund të futemi të gjithë ne, nënë Sanije,  
të lodhur, gjithë baltë,  
me rroba të mbytura nga pluhuri i tuneleve.  
Por ti kurrë s'na ke thënë e alarmuar:  
Kujdes! Fshijini këmbët te pragu!  
Më bëtë pis!  
Mos hyni!

Zëri yt me tingëllim prej nëne të mirë  
na ngroh më shumë se soba e barakës

sepse ti je zemërgjerë dhe e urtë si toka,  
që kurrë s'ankohet,  
që mban mbi supe  
kaq shumë njerëz punëtorë.

## V A T A

Ju nuk e njihni Vatën,  
atë plakun thatim  
që ka zbritur  
nga erërat e Vermoshit,

atë burrë të gjatë gjithë eshtra  
që, kur të thotë:  
«Mbrëmja e mir'!»,  
të duket sikur  
papritur ndodhesh  
mes bjeshkëve.

Ju nuk e njihni Vatën,  
karpentierin e kantierit tonë,  
atë plak të urtë që gjithë jetën e kaloi  
me pushkë në sup  
dhe natë e bishtuk  
në sy.

Në Va të Dejës e pashë Vatën  
duke u grindur në sportel  
për një biletë teatri.

Kurrë s'e kishim parë atë njeri të urtë  
të shtyhej e të shamatohej  
te dera e klubit,  
te sporteli i mensës.

Të nesërmen, në mbledhjen e kolektivit  
kupa e qiellit kishte rënë mbi flokët e thinjur të  
Vatës  
sepse edhe emri i këtij plaku të urtë ndodhej  
në listën e atyre  
që duhej të bënin autokritikë  
meqë kishin «thyer  
dyert e artit...»

## THYERJA E NATËS

*poemë*

### I.

Nata na hynte dikur

në sy,  
në trup,  
në bukë,  
në rroba,  
në këngë.

Me një pishë në dorë  
si me sëpatë  
fisi im mundohej  
errësirën të çante më dysh,  
po copat e territ ngjiteshin shpejt —  
aq shpejt  
sa ç'ngjitet nata  
kur e çan më dysh një vetëtimë.

2.

Sonte,  
i ulur më gjunjë mbi tokën e vet,  
populli im mbush gotat e syve  
me dritë.  
Sonte,  
njëherë e përgjithmonë,  
shuhet kuptimi i fjalës frëngji,  
sonte shëmbet njëherë e përgjithmonë mundësia  
që trupin e kombit tim  
ta ndjekë errësira nga pas;  
sonte do të na lindin fëmijët e parë  
që s'do të dinë kujt i thonë  
pishë, kandil, bishtuk, qiri.  
Prandaj propozoj që në fjalorët e ardhshëm  
.kuptimi i fjalës natë,  
brezave që vijnë,  
t'u shpjegohet afërsisht kështu:  
nata ka qenë pjesa më e madhe e jetës  
kur një popull  
veten nuk ka mundësi ta shohë mirë  
ku është,  
si është,  
si do të jetë.

Nata ka qenë koha  
kur një popull  
pa e kuptuar  
mund të hajë sytë e vet  
po qe se nuk ia kanë ngrënë më parë të tjerët.

Nata ka qenë koha  
kur nga dhimbja, uria, errësira,  
njeriu mund të hajë këngët e veta,  
gjuhën e vet  
fëmijët e vet,  
lirinë e vet.

Nata ka qenë koha  
kur të pushtetshmit  
ushqeheshin  
me mishin  
e lirisë së popujve të vegjël.

### 3.

Sytë e popullit tim  
kurrë s'janë shuar  
nga gishtat e zinj të natës.  
Kur koha s'pillte dot vetëtima,  
xixa e plumbit tregonte nëpër terr  
se si

e nga duhej ecur.

Netët nuk çahen dot kurrë,  
rrugët e historisë nuk gjenden dot kurrë  
pa qeleshen e bardhë në sy,  
pa kostum kombëtar,  
pa lahitë në gishta'  
e, mbi të gjitha,  
pa vetëtimën e pushkës  
në supet e kombit.

#### 4.

«Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, vëlla!»

Dhe kur s'kishim plumba  
dikush, si Naimi,  
trupin digje  
për të ndriçuar rrugën.  
Dikush, si Migjeni,  
mushkërive u vinte flakën  
me klithmën-vetëtimë:  
«Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vëlla!»

Po nata mbetej natë  
si një gur i rëndë dhe i palëvizshëm varri  
mbi kokën e së nesërmes.

5. Të parën gjë që bënte e zeza natë —  
hante këngët,  
gëzimin në sytë e kombit,  
hante dëshirën për dritë.  
Pastaj fillonte zhdukjen në seri të njerëzve  
që rrugën ndriçonin:  
«Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vëlla!»

Po në kohën e Partisë  
nga kjo tokë  
njëherë e përgjithmonë u fshi  
kalendari i vjetër,  
cikli i zakonshëm  
i ardhjes së natës.

6. Socializmi  
është  
drita e të gjithëve,  
dita e ditëve.

Socializëm do të thotë të kesh sy,  
të shohësh veten tënde drejt,  
të barabartë midis të barabartëve  
të shohësh kombin tënd pa pasur turp,  
të shohësh gjithë botën krenarisht,

të punosh, të gëzohesh, të dashurosh, të bësh  
fëmijë  
pa pasur frikën e natës në sy,  
Pa ndier peshën e territ në trup  
në bukë,  
në rroba,  
në këngë  
e në liri.

Socializëm do të thotë  
elektrifikim i përgjithshëm i vetes.  
Ndaj çdo ruazë, të kuqe o të bardhë,  
çdo nerv duhet ta lidhim me sistemin  
e përgjithshëm elektrik të Republikës,  
  
që nesër askush të mos na dalë përpara  
me natën pronë private,  
Që nesër askush të mos na djegë rrugën me  
kandilë e pisha kanunesh,  
që nesër nata të mos na lerë asnjë trashëgimtar,  
që nesër askush të mos ndihet mbi tokën e vet  
i vetmuar,  
i huaj,  
i tepërt.

## 7.

Sonte  
qielli nuk të bije fare në sy

me atë monotoninë e përjetshme të yjeve  
sepse toka shqiptare  
është krejt e elektrifikuar.

Sonte,  
i ulur më gjunjë mbi tokën e vet,  
populli im pi dritë,  
pi gjëzimin e dritës.

Më tepër se cilido popull tjetër në botë  
populli im sonte është i ngopur  
me gjëzimin e bardhë  
të dritës.

1970

## PENSIONI I BABAIT

poemë

Dyzet vjet shofer,  
dyzet vjet  
në buzë të aksidentit.

Lajmet e lindjeve të fëmijëve,  
lajmet e gëzuara apo të hidhëruara  
të lagjes  
dhe të atdheut  
ai i mirrte në rrugë.

Natën vinte,  
natën ikte.  
Në mes të natës na zgjonte të gjithëve.  
Në mes të odës,  
në një tepsi të madhe,  
ai derdhë kumbulla, rrush, mushmolla  
e na thosh:

Hani, fëmijët e babait!  
Rrituni, bij të babait!  
Të nesërmen nuk e gjenim në shtrat –  
kishte ikur.  
Natën vinte,  
natën ikte.

Po dhoma  
për disa ditë  
mbante erë kromi,  
erë deti,  
erë drithi.

Mbi të gjitha erërat,  
era e naftës  
nuk hiqej nga çarçafët,  
nuk hiqej nga govata,  
nga meraku  
dhe nga duart e nënës.

Dhe kur e prisnim  
e nuk kthehej,  
me mamanë e shqetësuar përpara,  
të gjithë ne fëmijët  
dilnim në mes të natës  
andej nga agjenci e vjetër,  
andej nga Kulleiri.  
Se ishin kohë të trazuara,

se bandat kishin vrarë disa shoferë  
që drithin e pushtetit popullor  
e çonin malësive...

Prisnim me ankth  
të vezullonte ndonjë sy makine  
tutje, nga rrug' e Elbasanit...  
Ku kishte ngelur?  
Mos ishte rrëzuar?  
Ishim shumë fëmijë,  
të gjithë të varur  
në supet  
e në timonin  
e babait.

Ktheheshim në shtëpi  
vetëm kur ndonjë shofer i vonuar,  
për të na qetësuar,  
na thosh:  
«Kthehuni, Stavrin e lashë  
në Qafë të Thanës.  
Një gomë i qe shpuar.  
Do t'ju vijë  
nesër në mëngjes  
sapo të hapni sytë...»  
Po shoferët gënjenin nganjëherë  
për të na qetësuar.  
Mirë bënин. Ata e dinin

se çdo të thotë  
shoferin e rrugëve të gjata  
në një natë me shqotë dhe armiq  
ta presë te agjenci e vjetër  
gruaja e kalamajtë e tij.

Kështu për dyzet vjet me radhë,  
derisa ne u rritëm,  
u bëmë burra,  
derisa të gjitha markat e makinave,  
që kanë hyrë në Shqipëri,  
u vjetëruan  
në duart  
e babait tim.

Por një ditë,  
krejt papritur për të,  
andej, nga rrug' e Voskopojës,  
një inspektor rrugor  
i doli përpara:  
«Akoma punon ti, Stavri?  
Akoma s'ke dalë në pension?  
Përse nuk i bindesh ligjit:  
të pushosh  
e të çlodhesh  
e nipërit e mbesat t'i gëzosh?»

S'e kishim parë kurrë aq të trishtuar,  
s'e kishim parë kurrë të përlotur,

s'e kishim parë kurrë aq të lodhur  
veç atë mbrëmje  
kur duhej të ndahej me timonin,  
kur duhej të shkëputej nga rrugët e atdheut,  
kur ne  
dhe vetë ai  
mundohej të përfytyronte veten,  
pa dashur,  
si plak.

Ishte e rëndë,  
tepër e rëndë.  
Papritur i ranë të gjitha dhëmbët.  
Pa patentë,  
pa rrugë në sy,  
pa erën e naftës në trup  
ai na ngjante si i huaj,  
si tjetër njeri.

C't'i thoshim?  
Të mbyllej në shtëpi,  
të mirrte torbën e pazarit,  
të mësonte të luante domino,  
të blinte tespie,  
të miqësohej me pleqtë e Korçës?....  
Duhej të fillonte nga e para  
si një i transferuar  
nga një qytet tjetër,

si një mysafir i panjohur  
në shtëpinë e vet,  
mes kalamajve të vet...

Duhej të lexonte rregullisht

lajmërimet e vdekjeve

që në biseda

të mos mbetej tuaf.

I veshur me kostum e kollaro,

me pardesy e jakë të bardhë,

me plakën, për herë të parë

duhej të shkonte në çdo fejesë

apo dasmë

apo lindje te komshinjtë,

duhej të hynte e të dilte

në dyert e farefisit

me rast e pa rast;

duhej, me një fjalë,

të bëhej shtëpiak.

Çdo mbrëmje

rrugët e Shqipërisë

me kalldrëm, me baltë a me asfalt

filluan të çmbështillen e të na futen

në sytë tanë,

në damarët tanë,

në shtretërit tanë.

Ai që s'grindej kurrë  
tani, kur më të rrallë pi një gotë,  
me plakën shamatohet ndonjëherë:  
«Ti ma çove djalin në Tiranë,  
ti ma mbylle diku, në një zyrë.  
M'i thartohen trutë nëpër libra, si guak,  
fytyrën ma ka të verdhë  
si një i oftikosur, qoftëlarg.  
Dhe fjalën (e ke vënë re?),  
shtatëqind herë në buzë e mat  
në vend që ta thotë-bramp!»....  
Për të,  
të gjithë ne  
duhej të ishim bërë shoferë....  
Sepse për të  
shoferët janë  
njerëzit që e kanë vdekje  
horizontin e një dhoma  
sado e mobiluar qoftë,  
njerëzit që pavarësinë s'e shkëmbejnë  
me asgjë në botë,  
njerëzit që s'i bëhen servilë kurrkujt,  
njerëzit që e kanë shumë të fortë ndjenjën

e klasës

e të solidaritetit,  
njerëzit që rrugët e atdheut i duan  
jo më pak  
se gruan,

fëmijët  
dhe shokët.

Mëngjeseve, kur shokët e tij pensionistë  
me torbën nën sqetull  
dalin në pazar,  
atë e gjen te agjenci e kamionave  
ose në park.

Vëllanë fònë të tretë,  
që si veten  
na e bëri shofer,  
që pagëdhirë  
del dhe e përcjell.  
Makinën ia ndez  
dhe e uron:  
«Rrugën e mbarë, bir!»

Dikur të gjithë ne,  
që jemi rritur në sediljet e makinave,  
me lot në sy  
i luteshim të na e jepte pak makinën....  
Por im atë është burrë i vjetër,  
ndaj s'mund t'i lutet  
një piciruku  
makinën t'ia japë  
«Vetëm një herë!»

Për të mos e fyer, vëllai,  
çdo mbrëmje  
tek agjencia e re,  
i thotë:

«Mere pak makinën, baba!  
Çoje deri në park;  
se, ja, shiko, kockat më janë mpirë. . .»

Dhe kur njëherë  
im vëlla,  
për shaka,  
bëri sikur harroi t'i jepte makinën,  
babai erdhi në shtëpi i nxehur,  
kërkoi raki  
dhe me mamanë u grind  
kot së koti.

(«Ty të kanë ngjarë!»)  
Të nesërmen u sëmur  
dhe nga shtëpia  
nuk doli një javë.

Por pas një jave  
doli përsëri nga agjencia e kamionave  
të presë makinat, shoferët, shokët  
që vijnë nga rrugët e gjata.

Rrugë të mbarë,  
ju që niseni!  
Mirë se erdhët,

ju që në mesnatë u kthyet.

Takohuni pak me tim atë,

që ju pret

në buzë të rrugës.

Por, si përgjigje

ju kurrë mos i thoni:

Pleqëri të mbarë!

Sepse shoferët,

me zemrën e madhe,

ku futin mijëra kilometra rrugë,

nuk plaken kurrë.

## PASQYRA E LËNDËS

Sonte dhe nesër në mëngjes .....	3
Ekskavatori 4 m <sup>3</sup> dhe poeti .....	4
Natën e mirë, polic! .....	5
Armiku i klasës .....	8
Fierza .....	10
Ura e prishur në dhjetor nga Drini .....	11
Peisazh nga Drini i qetuar pas natës së devijimit .....	14
Grupi i plasjes së minave .....	15
Peliçja ime në Va të Dejës .....	17
Në një xhirim të dështuar filmi .....	19
Kujtim për rrugën «Koço Çamçe» .....	24
Atentatori .....	28
Këngë djepi e kënduar në dy kohë të ndryshme .....	29
Për nënrat .....	31
Rrëfim sekret i gjyshes nuses sime .....	33
Bardhësi .....	37
Fjalët e fundit të Gjergj Kastriotit .....	38
Motiv nga viti 1920 .....	40
Maria Stuart .....	42
Rapsodi e re për qiellin .....	45
1 Maji .....	50
Ta dish .....	53
Marrëdhënie .....	54
Familjare .....	56
Kam takuar njëherë një njeri .....	58
Në organizatë .....	60
Moment lirik në maj .....	63
Buzë Shkumbinit, në Elbasanin e hekurt .....	65
Pushtimi i Çekoslovakisë .....	67
Babai .....	71
Përse nuk u inçizua estrada e një fshati në Devoll .....	72
Pas shiut .....	74
Balada e trenit .....	75
Pranë minatorëve .....	77
Nëna e kantierit .....	77
Vata .....	79
Thyerja e natës (poemë) .....	81
Pensioni i babait (poemë) .....	83
	90